



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V-të

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 9.

Prishtinë, më 10.02.2015 në ora 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225.

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Luljeta Veselaj - Gutaj, Rrustem Mustafa, Vjosa Osmani, Ilir Deda, Kujtim Paçaku, Arben Gashi dhe Valdete Bajrami.

Munguan:, Xhavit Haliti, Blerim Shala dhe Sllobodan Petroviq.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj.Valdete Bajrami, zëvendëskryetare e parë e Komisionit.

Rendi i Ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 30.1.2015**
- 3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për MSA-në për vitin 2015;**
- 4. Formimi i Grupit Punues për monitorimin e Ligjit Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin me trafikimin me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.**
- 5. Formimi i Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale;**
- 6. Të ndryshme**

Kryetarja pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua.

- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 30.1.2015 .**

Procesverbali u miratua me vërejtjen e Ilir Dedës.

3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për MSA-në për vitin 2015;

Kryetarja: tha se përveç Planit të Veprimit për MSA-në për vitin 2015 i cili iu është shpërndarë me kohë kemi pranuar edhe Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Progresit (PVRP) 2015, këto dy dokumente janë gati të njëjta, por vetëm në pjesën narrative janë disa ndryshime. Në mungesë të ministrit të integriteteve evropiane i cili ka qenë i ftuar të merë pjesë në mbledhje, ne sot mund ta shqyrtojmë, por në mbledhjen e radhës ku do të merë pjesë edhe ministri do të mund të mund të lëshohemi në analizë më të thuktë, lidhur me këtë hapi debatin.

Ilir Deda: propozoj që pikën e tret ta shtyjmë për mbledhjen e radhës kur do të jetë prezent edhe ministri, ku do të fokusohemi më shumë në mënyrë që mos të përsëriten gjërat.

Me këtë propozim u pajtuan edhe anëtarët tjerë të komisionit, sepse e konsideruan si pik të rëndësishme dhe kërkon trajtim të veçantë dhe të shqyrtohet së bashku me ministrin.

Pas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve kryetarja nxori këtë:

Përfundim

Shqyrtimi i Planit të Veprimit për MSA-në për vitin 2015 u shty për mbledhjen e radhës, ku do të jetë prezent edhe ministri për Integritete Evropiane.

4. Formimi i Grupit Punues për monitorimin e Ligjit Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin me trafikimin me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Kryetarja: theksoi se ky ligj ka nevojë për një mbikëqyrje të mirëfilltë rreth asaj se si po zbatohet në praktik, andaj kërkoj që të formohet grupi për monitorimin e tij.

Pas diskutimeve dhe propozimeve Kryetarja nxorri këtë:

Përfundim

Monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin me trafikimin me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit do ta udhëheq Grupi punues me këtë përbërje.

Teuta Sahatqija udhëheqëse e grupit
Luljeta Veselaj - Gutaj
Xhavit Haliti
Valdete Bajrami
Kujtim Paqaku

5. Formimi i Grupit Punues për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale;

Kryetarja: pas propozimeve të anëtarëve se kush do të jetë në grupin për monitorimin e zbatimit dhe implementimit të këtij ligji në praktik nxori këtë;

Përfundim

Monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale, do ta udhëheq grupi punues me këtë përbërje:

Ilir Deda udhëheqës i grupit
Vjosa Osmani
Rrustem Mustafa
Arben Gashi
Sllobodan Petroviç

Pas caktimit të grupeve punuese, Kryetarja tha se nuk do të thotë se përveç anëtarëve të caktuar në grupe nuk mund të marrin pjesë edhe anëtarët tjerë, pjesëmarrja është e hapur për të gjithë .

6. Të ndryshme.

Rrustem Mustafa: theksoi se gati në çdo mbledhje nuk po mundemi t' ikim çështjes së imigrimit ilegal , veprimet tona nuk janë efektive qofshin pozitë apo opozitë dhe po e irritojnë ambientin dhe pe nxisin edhe ma shumë migrimin, qoftë me protesta dhe me vendimet e Qeveris,mori shembull vendimin e fundit të Qeveris për faljen në bllok të borxheve dhe protestat e fundit që kanë ndikua që njerëzit me lëshua vendin,prandaj duhet me qenë më të vëmendshëm me këtë situatë .

Kërkoj që si komision me thirr një seancë dhe me e rregullua së pari komunikimin mes veti dhe me të gjithë mekanizmat qeveritar dhe me dal merë disa rekomandime .

Nuk po them për ata që veç kanë vendos me migrua por për të ardhmen me u përpjek për njerëzit nëpër fshatra të thella që kanë me ju kthye punës dhe aty me investua.Duhet të subvencionohen për mes pushteteve lokale dhe pushtetet lokale tani i kanë mekanizmat dhe e kanë matjen se kush mundet me punu me bujqësi dhe me blegtori.Vetëm me plan afatgjatë tue ju kthye punës në vendet tona mund të ndikoj që njerëzit mos me e lëshua vendin,ka politika kombëtare që mund zhvillohen që njerëzit të punojnë tokën e vet, por mos të mendojmë se me programe të shpejta siç po mendojmë ne dhe me disa propozime vetëm e kanë randua ambientin edhe ashtu të pa dëshiruar, do të doja shumë ta riparojmë komunikim me qytetar dhe ndër veti si e vetmja metodë.

Kryetarja: lidhur me migrimin tha se e kemi pas një seancë ku është dal me një rezolutë ku janë dhënë disa rekomandime.

Rrustem Mustafa: tha se kishte marrë pjesë në seancë, por rekomandimet e dala nuk munden shpejt me e përmirësuar imazhin e qytetarëve për me qëndrua në vendin e vet kërkoj seancë të mendimit pozitiv që me e rregullua komunikimin e ndër sjelltë për me dal me komunikim më të shpejt dhe më efikas.

Vjosa Osmani: theksoi se në debatin që e patëm javën e kaluar secili deputete ka pas të drejt me propozua ide dhe rekomandime dhe ato rekomandime janë pranuar në mënyrë shumë të hapur nga iniciuesit e debatit në rekomandimet përfundimtare.

Tani është tepër herët të flasim për një realizim të tërë apo të pjesshëm të atyre rekomandimeve sepse janë bërë vetëm disa dit që ato i kemi kaluar, shtoj se qytetarët kanë nevojë që ne ta realizojmë detyrën kushtetuese të mbikëqyrjes mbi Qeverinë e Kosovës dhe të kërkojmë në çdo seancë, nëpërmjet pyetjeve parlamentare dhe interpelancave të ministrave të realizohen ato rekomandime të cilat i kemi miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Askush nuk na ndalon të dalim me propozime konkrete, sepse edhe rajoni ka pas probleme të ngjashme, jo deri në këtë masë. U përmend nga z. Mustafa zhvillimi i bujqësisë, ne mund ta fitojmë ministrin e bujqësisë të bisedojmë rreth asaj se si mundemi ne si komision të ndihmojmë të fitojmë fonde të IPA-së apo fonde tjera të BE-së të cilat do të shfrytëzoheshin në këtë aspekt. Pra tu ndihmojmë qytetarëve ekonomikisht dhe rrjedhimisht të parandalojmë imigrimin ilegal. Si shembull përmendi Irlandën veriore, në mandatin e kaluar si komision kemi pas një vizitë atje dhe jemi njoftuar se ata çdo vit fitojnë miliona euro nga fondet e IPA-së për një projekt të quajtur projekti i paqes i cili shfrytëzohet për integrimin e tyre ekonomik, zhvillimin ekonomik, ndihmë ekonomike për qytetarët që jetojnë atje dhe ju ka ndihmuar jo vetëm të qëndrojnë aty dhe jetojnë pa probleme të mëdha duke ju dhënë mundësi ekonomike qytetarëve, pra këto janë gjëra konkrete që ne si komision mund të ndihmojmë me ministrat e resoreve konkrete.

Në vazhdim shprehi një breng rreth një lloj keqpërdorimit të rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Kosovës, sepse të nesërmen policia e Kosovës duke u thirrur ne rezolutë ka dal dhe i ka ndaluar qytetarët dhe lëvizjen e tyre të lirë, mirëpo ata e kanë bërë këtë, duke thënë se Rezoluta e Kuvendit po na autorizon, që nuk është e vërtetë sepse nuk ka asnjë pikë në rezolutën e Kuvendit që autorizon ndonjë institucion që ti pengoj qytetarët të lëvizin. Ne si deputet të Kuvendit duhet të kujdesemi që dokumentet që vet i kemi sponsorizuar dhe miratuar mos të keqpërdoren në aspekte të tilla.

Kryetarja: shtoi se në Rezolutën e miratuar, ministria e punëve të brendshme është udhëzua që ti ndal rrjetet kriminale e jo ti ndal lëvizjet e qytetarëve.

Ilir Deda: tha se kishte disa çështje për ti ngritur;

1. Sipas informatave nga policia por nuk po publikohen, janë 230 mijë njerëz që e kanë lëshuar Kosovën, 13% e popullatës na ka ik, është eksod kjo dihet tashmë, prapë po e përsëris, urgjentisht ministri i punëve të brendshme duhet me ardhë dhe me i publiku shifrat tamam në komision dhe nëse duhet me qenë mbledhja e mbyllur, le të jetë e mbyllur.

2. Pajtohet me znj. Osmani që nuk ka të drejt policia të thirret në rezolutë dhe ti ndaloj qytetarët, sepse koha ndalimit të qytetarëve për me dal nga shteti, ka mbaru.

Në vazhdim tha se asnjë njeri nuk e kam dëgjuar që po thotë se po iki nga protestat, mendoj se nuk është në rregull që tash mu mundue prapë me shpërqendrua arsyen e ikjes së njerëzve, njerëzit po ikin se mbas 15 viteve të zhvatjes së këtij vendi nuk po shohin të ardhme dhe nuk po shohin ndryshim, atëherë duhet me i quajti ashtu si e kanë emrin, zhvatja, keqpërdorimi, mbytja e shpresës dhe ajo është arsyeja e migrimit të popullit tonë.

3. Rezolutën që e kemi aprovuar një zëri në Kuvend ka ndryshime ligjore të cilat i sugjerohen Qeveris për me pas lehtësira të cilat duhen me u bërë me plotësim ndryshim të ligjeve ekzistuese. Sugjeroj që nëse deri në javën e ardhshme nuk ndermirën këto hapa prej ekzekutivit, atëherë duhet me i ftu ministrat përgjegjës me na raportuar se çka janë duke bërë në plotësim ndryshim të ligjeve të cilat kërkohen prej rezolute, ajo rezolutë nuk është pamflet i cili është aprovua dhe asgjë kurrkujt dhe njerëzit tan po vazhdojnë me ik. Puna jon duhet me qenë pak më intensive dhe ekzekutivi duhet me ardhë me na raportua saktë se cilat veprime që po i ndërmarrin.

Kryetarja: e tha z. Deda se ju u bazuat në numra jo zyrtare dhe unë po bazona në informata zyrtare, shumica e rekomandimeve janë të parapara edhe para fillimit të protestave, ndryshimet çfarë janë, TVSh-ja të hyj brenda e jo jashtë, është në fjalimin e kryeministrit në ditën kur është zgjedhur, është treguar që në një afat të caktuar ajo është prioritet i planit të Qeveris që TVSh-ja të hyj brenda e jo jashtë, shumica e lehtësirave doganore shumica janë të parapara, ligji ndër të fundit që e kemi miratuar ka qenë ligji për lehtësirat doganore ku një pjesë e pajisjeve është, pra ligji duhet të aplikohet, nuk do të thotë që nuk duhet ti thërrasim ministrat në raportimet zyrtare dhe të shohim se cilat ndryshime janë bërë dhe cilat ndryshime priten të bëhen, pasi që në parandalimin e migrimit ilegal dhe kthimin në migrim të kontrolluar sepse migrimi ekziston qysh ekziston njerëzimi, por ai migrim mos të kalojë në suazat të një numri të madh të pa kontrolluar dhe në anën tjetër të formohen kushte për një mirëqenie ekonomike.

Kujtim Paçaku: tha se shpesh po dëgjoj në media dhe në Parlament për migrimin legal dhe migrimin ilegal, vet rezultatet e kalimit të kosovarëve për mes kufirit të Hungarisë po dyshojmë se është migrim ilegal. Shprehi shqetësimin duke thënë se institucionet e Kosovës është dashtë të reagojnë më herët sepse ky migrim ka filluar shumë më herët dhe ndër të parët ishin të komunitetit rom. Me shkuarjen e mediave tona në shtetet ku shkojnë qytetarët tanë atëherë u bë buj më e madhe. Nëse kthehen nuk e dimë se ku do të kthehen sepse një pjesë e tyre i kanë shit shtëpitë dhe nuk kanë mundësi elementare të kthehen aty. Nëpër mjet mediave në gjuhën rome për komunitetin tim kam sugjeruar mos të shkojnë dhe së paku mos ti shesin shtëpitë e tyre, Në vazhdim tha se nëse pjesëtarët e komunitetit rom kthehen duhet me pas prioritet sepse varfëria në Kosovë tani më është e kategorizuar, tragjedia të cilit i ndodhi një fëmijë në Fushë Kosovë ka qen për bukë nëpër kontejnerë duke kërkuar fëmija i komunitetit rom. Pra kategorizimi i varfërisë duhet të jetë i përqendruar, falja e borxheve nuk duhet të jetë për të gjithë i njëjtë, sepse ka njerëz që kanë përfutur prej këtyre borxheve por duhet të fokusohemi për kategorinë e mesme dhe të varfër.

Luljeta Veselaj – Gutaj: theksoi se kjo temë është shqetësuese për të gjithë ne dhe në të gjitha periudhat që ka ekzistuar njerëzimi ka pas dhe do të ketë migrim, por ai fluks i migrimit duhet ta ketë një nivel sa dhe deri kur do të migrojnë. Janë disa kategori që po migrojnë, ne njohim qytetar të cilët kanë punuar dhe kanë pas një pagë solide dhe ka marrë gruan dhe fëmijët dhe ka dalë në rrugë, Cili është motivi kush po e inicion këtë, mendoj se ne duhet të bashkohemi dhe ulemi dhe të diskutojmë dhe ta gjejmë se kush është inspirues që po i nxit këta njerëz, element tjetër është se qytetarët tanë po shkojnë në Serbi dhe me 1000 euro po e marrin një letër njoftim për me dalë dhe me i kalu kufijt. Ne duhet të bëjmë përpjekje mu si komision dhe të këmbëngulim në liberalizim të vizave, që ata që kanë ambicie me dalë në Evropë me pa apo edhe me jetë, të kenë mundësi si shtetas Kosovar të dalin e jo të Serbisë. Ne duhet të ulemi dhe shumë hollësisht të diskutojmë sepse ka njerëz që janë në gjendje shumë të rëndë ekonomike, por ka edhe njerëz që e kanë shtëpinë punën dhe e kanë marrë rrugën të cilën nuk e din se ku do të shkojnë.

Valdete Bajrami: konfirmoj edhe një herë se kjo situatë është shqetësuese për të gjithë, ky migrim tha se nuk është vetëm këta 6 muajt e fundit siç po e quajnë disa, por ky migrim ka qen edhe më herët, ndoshta jemi mësuar që pa u bë shumë e madhe nuk ndërmarrim masa dhe kjo po rezulton në çështjen e fundit. Në vazhdim tha se pajtohem me atë që u tha nga parafolësit që ti japim Qeveris një afat prej një javësh apo 10 ditësh pas miratimit të rezolutës që ti ndërmarrin masat e nevojshme, por nëse ata nuk e aplikojnë në përpikshmëri rezolutën, atëherë ne duhet të ndërmarrim masa dhe duhet të kemi debat më të ashpër në seanca. Nuk do të thotë që me atë rezolutë përfundojnë problemet e njerëzve tanë, por kjo është ndoshta një shpresë që në të ardhmen ne me hartu edhe dokumente tjera që janë në të mirën e qytetarëve. Në ndërkohë duhet të mendojmë edhe për njerëzit që do të riatdhesohen, po ashtu është shqetësuese që u përmend që po largohen edhe njerëzit që punojnë, nuk mundemi me i fajësu se nëse një prind i ka tre fëmijë dhe e merë një pagë dhe thonë për çka po e lëshon ai Kosovën, ai për vete mund të thotë se e kam një pagë, po çka po i len fëmijut mbrapa.

Luljeta Veselaj -Gutaj: shtoj duke potencuar se çështja e fëmijëve është shumë e ndjeshme dhe brengosëse sepse këta fëmijë që po e lëshojnë shkollën, ku po shkojnë dhe sa po humbin, prindi si prind mendon gjërat më të mira të mundshme për fëmijun e vet, por në këtë rast jo, po mendon me e bë një zgjidhje por po i bënë më keq sepse po e qet rrugëve. Edhe nëse stabilizohen në një vend nuk do të mund të kyçen menjëherë në shkollë, por kur do të vijnë te pjesa e kthimit ata fëmijë do ta humbin një vit të shkollës e kanë humb një gjenerat, një shoqëri. Pra ne këtu duhet të bëjmë përpjekje që këta fëmijë që kanë lënë bankat shkollore të kthehen sa më shpejt dhe mos të mbesin rrugëve dhe të humbin shumë.

Kryetarja: tha se kjo temë po shihet që kërkon një qasje multidimensionale, rezoluta mendoj se është gjithëpërfshirëse por përsëri si temë kërkon një diskutim më të gjerë. Andaj në bazë të diskutimeve që u bënë si përfundim tha se do ta organizojmë një tryezë ku përheq ministrave do ti ftojmë edhe aktorët tjerë për të diskutuar për këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Teuta Sahatqija